



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

“PËR REGJISTRIN ELEKTRONIK ONLINE TË SHITJEVE”

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 159, datë 29.09.2021
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 214, datë 25.11.2021

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave të funksionimit, identifikimit dhe raportimit të të dhënave të shitjes së policave të sigurimit të detyrueshëm në Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve, referuar më poshtë si Regjistër, të instaluar në Qendrën e Informacionit të Sigurimit të Detyrueshëm pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe në zbatim të pikës 2, të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe nenit 31, pikat 1/a, 1/c, 4 dhe 7, të Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Kjo rregullore është e detyrueshme për t’u zbatuar nga shoqëritë e sigurimit, agjentët/shoqëritë e agjentëve, punonjësit e shoqërive të sigurimit, si dhe në rast kërkesë nga brokerat/shoqëritë e brokerimit, të licencuar nga Autoriteti për të ushtruar veprimtari në klasat që lidhen me sigurimin e detyrueshëm.

Neni 4
Përkufizime

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Policë” - është kontrata e sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësishë së pronarit/përdoruesit të mjetit motorik për dëmet e shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i këtij mjete si dhe kontrata e sigurimit të pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik.
2. “Përdorues i autorizuar” - është punonjësi i shoqërive të sigurimit, agjenti i shoqërive të sigurimit apo të shoqërive të agjentëve, i cili licencohet nga Autoriteti.

Neni 5

Raportimi i policave

1. Shoqëria e sigurimit, agjentët/shoqëritë e agjentëve do të raportojnë në kohë reale shitjen e çdo police sigurimi të detyrueshëm, në Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve të instaluar në Qendrën e Informacionit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.
2. Pavarësisht përcaktimeve të pikës 1, të këtij neni, shoqëritë e sigurimit, agjentët/shoqëritë e agjentëve mund të raportojnë shitjen, në një kohë të mëvonshme vetëm në raste të veçanta kur ka ndërprerje të komunikimit të sistemeve që mundësojnë shitjen e policës.
3. Procedurat për raportimin e rasteve dhe miratimit nga Autoriteti, referuar pikës 2 të këtij neni, përcaktohet në Aneksin 3 të kësaj rregulloreje.

Neni 6

Shitja e policave në Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve

1. Shoqëria e sigurimit, agjentët/shoqëritë e agjentëve marrin të gjitha masat për të përshtatur sistemet informatike respektive të shitjeve online të policave për të operuar në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje. Një përdorues i autorizuar nuk mund të kryejë shitjen e policave të sigurimit nga më shumë se një terminal shitjeje dhe vendndodhje.
2. Shoqëria e sigurimit njofton paraprakisht Autoritetin për sistemet e saj të shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm. Sistemet e shitjes së policave duhet, të paktën, të përmbushin këto kritere:
 - a. Të ofrojnë akses të pakufizuar për shitjen e policave në çdo kohë që agjenti kërkon të lëshojë një policë;
 - b. Të identifikojnë agjentët në mënyrë unike duke përdorur kodin e miratuar nga AMF;
 - c. Çdo agjent i cili shet për më shumë se një shoqëri sigurimi duhet të ketë një kopje të marrëveshjes midis shoqërive të sigurimit në ambientet e tij;
 - d. Sistemi që përdor agjenti për shitjen e policave duhet të jetë pjesë e sistemit të shoqërisë për të cilin është licencuar duke u lidhur direkt me të, pa ndërhyrje nga sisteme të tjera të paautorizuara.

3. Shoqëria e sigurimit informon Autoritetin (Drejtorinë e TI) për skemën e rrjetit dhe të gjitha sistemeve përgjegjëse për shitjen apo raportimin e policave nëpërmjet një shkrese zyrtare dhe e-mail (it@amf.gov.al). Njoftimi kryhet përpara se të ndodhin ndryshimet në rrjet apo në sisteme duke u shoqëruar me argumentimin për qëllimin e ndryshimit.
4. Autoriteti ka të drejtë të ushtrojë funksionet e tij mbikëqyrëse të sistemeve, në çdo kohë, duke marrë për bazë këto kritere, por edhe të tjera bazuar në standardet e auditimit të sistemeve të informacionit dhe teknologjisë.
5. Polica e sigurimit identifikohet nëpërmjet numrit unik të gjeneruar automatikisht nga Regjistri, i cili printohet në hapësirën përkatëse të policës. Shitja e policave nuk realizohet në rast se mungon numri unik i gjeneruar nga Regjistri.
6. Shoqëritë e sigurimit, agjentët/shoqëritë e agjentëve duhet të marrin masat që numri i serisë së policës të jetë unik për të gjitha produktet e sigurimit të detyrueshëm që ofron shoqëria dhe të mos përsëritet në vitet në vazhdim. Ky numër duhet të fillojë çdo vit me dy shifrat e fundit të vitit aktual. (Shembull: Viti 2021 = 21xxxxxxx).
7. Shoqëritë e sigurimeve, agjentët/shoqëritë e agjentëve, njoftojnë Autoritetin për punonjës/punonjësit e autorizuar për administrimin e sistemeve. Për çdo ndryshim në lidhje me punonjës/punonjësit e autorizuar për administrimin e sistemeve informatike respektive të shitjes online, shoqëritë e sigurimeve njoftojnë me shkrim Autoritetin brenda 24 orëve.
8. Shoqëritë e sigurimeve, agjentët/shoqëritë e agjentëve, plotësojnë saktë të gjitha rubrikat e policës.
9. Shoqëritë e sigurimeve, agjentët/shoqëritë e agjentëve, janë përgjegjës për zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave në Regjistër.

Neni 7

Mirëmbajtja dhe siguria

1. Shoqëritë e sigurimit kontribuojnë financiarisht për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Regjistrit Elektronik Online të Shitjeve, me qëllim garantimin e funksionimit të pandërprerë të tij.
2. Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit në AMF, në zbatim të Planit të Vazhdimësisë së Aktivitetit, harton Planin *Disaster Recovery* (DRP), Protokollat e sigurisë dhe komunikimit me sistemet e shoqërive.

Neni 8

Specifikimet Teknike

1. Regjistri gjeneron një numër unik, i cili ka karakteristikat e renditura në Aneksin 1, bashkëngjitur kësaj rregulloreje.
2. Skema e detajuar dhe karakteristikat e procesit të identifikimit dhe raportimit të shitjeve të policave tregohen në Aneksin 2, bashkëngjitur kësaj rregulloreje.
3. Komunikimi i sistemeve informatike respektive të shitjeve me Regjistrin, në funksion të dhënies së aksesit përdoruesve të autorizuar, duhet të realizohet nëpërmjet dy linjave të komunikimit (parësore dhe back-up). Për secilën nga linjat e komunikimit duhet të përdoren adresa unike IP.

Neni 9

Mënyra e funksionimit

1. Të dhënat e kërkesës për shitje nga shoqërinë e sigurimit duhet të vijnë në kohe reale në Regjistrë.
2. Për çdo kërkesë, programi gjeneron automatikisht një numër unik të rastësishëm, i cili shtypet në policë në momentin e lëshimit.
3. Ky numër i rastësishëm unik është i trajtës *alfanumerike* dhe shërben për të vërtetuar raportimin e policës në bazën e të dhënave qendrore në Autoritet.
4. Data e shitjes së policës së sigurimit nuk duhet të jetë më herët se 15 ditë nga data e përcaktuar në policën e sigurimit si data e fillimit të mbulimit. Në rastet e rinovimit, data e fillimit të mbulimit nuk duhet të jetë më herët se data e mbarimit e përcaktuar në policën e sigurimit.
5. Me përjashtim të pikës 4 të këtij neni, në rastet kur shoqëria e sigurimit është fituese në një procedurë prokurimi për pajisjen me polica të sigurimit të detyrueshëm të një subjekti, data e shitjes së policës së sigurimit mund të jetë më shumë se 15 ditë nga data e përcaktuar në policën e sigurimit si data e fillimit të mbulimit. Në këtë rast, shoqëria e sigurimit njofton Autoritetin, i cili pasi shqyrton kërkesën, mundëson raportimin e këtyre kontratave sipas kërkesës përkatëse, duke i caktuar shoqërisë së sigurimit një afat për realizimin e procesit.
6. Shoqëria e sigurimit raporton të dhënat e një police sigurimi vetëm një herë, duke u bazuar në numrin e shasisë për një periudhë të caktuar vlefshmërie.
7. Raportimi i të dhënave duhet të kryhet sipas dispozitave të kësaj rregulloreje dhe nuk duhet të ketë ndryshime të të dhënave të raportuara në krahasim me ato të printuara në

policën e sigurimit të detyrueshëm.

8. Shoqëria e sigurimit rakordon çdo muaj me Autoritetin, statusin e policave të raportuara në Regjistër me ato të raportuara në sistemet e brendshme të vetë shoqërisë. Rakordimi bëhet në fillim të muajit pasardhës me qëllim eksportin e të gjithë të dhënave nga data 1, ora 00:00 deri në datën 30/31 ora 23:59, sipas procedurës në Aneksin 7, bashkëngjitur kësaj rregulloreje.
9. Procedura e anulimit të policave mund të kryhet vetëm nga personeli i autorizuar i shoqërisë së sigurimit, brenda 30 ditëve nga data e fillimit të vlefshmërisë së policës. Në rastet e riaktivizimit, kur kemi të bëjmë me anulim gabimisht të policave, rasti duhet të raportohet në Drejtorinë e TI, në AMF, në e-mailin: support@amf.gov.al, si dhe në emailin: it@amf.gov.al, brenda 24 orësh dhe për policat e Kartonit Jeshil duhet të raportohen brenda 4 orësh.
10. Autorizimi apo pezullimi i përdoruesve që raportojnë në Regjistër realizohet sipas procedurës në Aneksin 4, bashkëngjitur kësaj rregulloreje.
11. Shoqëria reflekton në Regjistër rastet e kthimit të policave, duke bërë përditësimin e statusit të policës në statusin “Kthyer”.
12. Shoqëritë e sigurimit, nëpërmjet punonjësve të autorizuar, konfigurojnë manualisht në sistemin/portalin e Autoritetit mjetet pa targë, individët me ID të huaj apo institucionet e paregjistruara në QKB, me qëllim vijimin e shitjes së policave sipas procedurës në Aneksin 6, bashkëngjitur kësaj rregulloreje.

Neni 10

Sanksionet

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj rregulloreje, është objekt sanksionimi sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

ANEKSI 1

KARAKTERISTIKAT SPECIFIKE TË GJENERIMIT TË NUMRIT UNIK IDENTIFIKUES TË POLICËS SË SIGURIMIT NË REGJISTRIN ELEKTRONIK ONLINE TË SHITJEVE.

Formati do të jetë:

- {KLASA, KODI I AGJENTIT, PESË NUMRAT E FUNDIT TË SHASISË, HASH (HASH=algoritmi i enkriptimit, i cili nuk do të jetë sekuencial dhe do të aprovet nga AMF)} në total jo më shumë se 30 karaktere;
- Për *inpute* do të përdoren Klasa e Automjetit sipas kategorizimit të Urdhrit të Ministrisë të Financave, kodi i agjentit, informacione të policës si koha e lëshimit, targa e automjetit, shasia, patenta;
- Të gjenerojë numra të rastësishëm sipas një algoritmi të përcaktuar nga Autoriteti;
- Numrat e gjeneruar të jenë unik;
- Algoritmi të ndryshohet vetëm me miratim nga Autoriteti;
- Të mos realizohet shitja në rast se mungon numri unik i raportimit.

ANEKSI 2

I. SKEMA E DETAJUAR, KARAKTERISTIKAT E PROCESIT TË IDENTIFIKIMIT DHE RAPORTIMIT TË SHITJEVE TË POLICAVE TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM MOTORIK

Kërkesa për policë të re:

1. Operacioni fillestar i web service [doLogin](#)
2. Operacioni i dytë i web service [doRequest](#)
3. Operacioni i tretë i web service [doGetVehicleData](#)
4. Operacioni i katërt i web service [doGetBonusMalusData](#)
5. Operacioni i pestë i web service [doSendData / doSendDataSPP \(Polica e Pasagjerëve\)](#)
6. Operacioni i gjashtë i web service [DoSendPaymentData](#)
7. Operacioni i shtatë i web service [doSavePolice](#)

Anulimi i një policë ekzistuese:

1. Operacioni fillestar i web service [doLogin](#)
2. Operacioni i dytë i web service [doCancelPoliceRequest](#)
3. Operacioni i tretë i web service [doCancelPolice](#)

Dublikimi i një policë ekzistuese:

1. Operacioni fillestar i web service [doLogin](#)
2. Operacioni i dytë i web service [doDuplicatePoliceRequest](#)
3. Operacioni i tretë i web service [doGetVehicleData](#)
4. Operacioni i katërt i web service [doSendDataForDuplicate / doSendDataForDuplicate SPP \(Polica e Pasagjerëve\)](#)
5. Operacioni i pestë i web service [doSaveDublikate](#)

Kthimi i një policë ekzistuese:

1. Operacioni fillestar i web service [doLogin](#)
2. Operacioni i dytë i web service [doReturnPoliceRequest](#)
3. Operacioni i tretë i web service [doSendReturnData](#)
4. Operacioni i katërt i web service [doReturnPolice](#)

ANEKSI 3

PROCEDURA E RAPORTIMIT NË RAST TË MOSFUNKSIONIMIT TË SISTEMEVE

1. Procedura e raportimit në një kohë të mëvonshme është raportimi i policave nga shoqëritë e sigurimit në Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve, në një datë pas asaj të nënshkrimit të policës.
2. Raportimi në një kohë të mëvonshme lejohet vetëm në raste të veçanta kur ka ndërprerje të komunikimit të sistemeve që mundësojnë shitjen e policës. Këtu nuk përfshihen problematikat e infrastrukturës që mund të shfaqen tek agjentët apo shoqëritë.
3. Nga momenti kur rikthehet shërbimi, shoqëria e sigurimit ka afat 5 ditë pune që të dërgojë me shkresë zyrtare kërkesën për hedhjen në sistem të policave të paraportuara, së bashku me dokumentacionin që vërteton shkaqet e pamundësisë së realizimit të shitjes në kohë reale.
4. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Autoriteti njofton shoqërinë e sigurimit për hapat e mëtejshëm në lidhje me përfshirjen ose jo të policave në sistem.
5. Në rast miratimi, procesi i raportimit të policave realizohet nëpërmjet serverit të shoqërisë. Shoqëria e sigurimit merr të gjitha masat e nevojshme për të regjistruar për një periudhë 3 ditore të gjitha policat e paraportuara me datën e shitjes.
6. Çdo policë e raportuar gjatë kësaj procedure duhet të përmbajë numrin e protokollit dhe datën e shkresës, me anë të së cilës janë raportuar në Autoritet.

ANEKSI 4

AUTORIZIMI (HAPJA) DHE PEZULLIMI (MBYLLJA) E PËRDORUESVE QË RAPORTOJNË NË REGJISTRIN ELEKTRONIK ONLINE TË SHITJEVE

1. Hapja e aksesit për përdoruesit e rinj të Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve

- Konfigurimi i një përdoruesi të ri në Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve nënkupton dhënien e aksesit për një kod unik i lidhur me kredencialet e një punonjësi shitje/agent, të vënë në dispozicion nga shoqëria e sigurimit për të cilën është i autorizuar të shesë policat e sigurimit të detyrueshëm.
- Kërkesat e paraqitura nga shoqëritë e sigurimit për konfigurimin e përdoruesve të rinj trajtohen nga Drejtoria e Licencimit në Autoritet dhe më pas kjo drejtori autorizon Drejtorinë e IT me email (it@amf.gov.al) për hapjen e aksesit.
- Shoqëria e sigurimit, pas miratimit nga Autoriteti të punonjësit të shitjes apo agentit, depoziton informacionin sipas tabelës së mëposhtme:

Rrethi	Emër Agjencie	Kod Agjencie	Kod Agjenti	Përdorues	Emër	Mbiemër	Adresa				Tel/Cel
								NIPT	Nr. Sigurime Shoqërore	Nr. Personal	

2. Pezullim (mbyllje) i aksesit të një përdoruesi në Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve

- Pezullimi i një përdoruesi në Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve, nënkupton mbylljen e aksesit të shitjes së policave për kodin unik të lidhur me kredencialet e përdoruesit të pezulluar.
- Pas kërkesës së paraqitur nga shoqëria e sigurimit pranë Autoritetit, me të dhënat si më poshtë:
 - Emër, Mbiemër i agentit;
 - Kod i agentit;
 - Emrin e shoqërisë së sigurimit.
- Drejtoria e Licencimit autorizon me email në adresën it@amf.gov.al Drejtorinë TI për pezullimin (mbylljen) e përdoruesit në Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve.
- Drejtoria TI procedon me mbylljen e aksesit.

3. Autorizimi i përdoruesit të sistemeve online të shoqërisë së sigurimit

Drejtoria IT autorizon përdoruesit në Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve për sistemin e shitjeve (rezervimin) të policave online nëpërmjet platformave mobile apo web.

ANEKSI 5

LLOJET DHE STATUSET E POLICAVE TË RAPORTUAR NË REGJISTRIN ELEKTRONIK ONLINE TË SHITJEVE

Llojet e policave

Llojet e policave përcaktohen/identifikohen sipas formatit të fushës KODI_LLOJIT_POLICËS, e cila merr vlerat:

1. TPL;
2. Karton Jeshil;
3. Policë Kufitare;
4. Policë e Sigurimit të Pasagjerëve.

Periudha e vlefshmërisë së policave

Në varësi të periudhës, e cila përcaktohet/identifikohet sipas formatit të fushës KODI_PERIUDHËS, llojet e policave kategorizohen sipas periudhave të mbulimit:

- Policat TPL janë për një periudhën 1 vjeçare.
- Kartoni Jeshil janë për periudhat 15 Ditore, 1, 3, 6 Mujore dhe 1 Vjeçare;
- Policat kufitare janë për periudhën 15, 30, 45 Ditore dhe 6 Mujore;
- Policat e Sigurimit të Pasagjerëve janë vetëm për periudhën 1 Vjeçare.

Statusi i policave

1. Statusi 1

Policat e shitura që identifikohen dhe raportohen në Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve identifikohen me status 1.

2. Statusi 2

Pas çdo anulimi nga përdoruesit e autorizuar të policës së raportuar “e shitur” në Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve, statusi i policës kalon 2 dhe ruhet dhe data e ndryshimit të këtij statusi.

3. Statusi 3 dhe 4

Dublikata është një kopje e një police të vlefshme, e cila lëshohet nga po e njëjta shoqëri sigurimi dhe për të njëjtin mjet. Rastet kur lëshohet një dublikatë janë:

- Në momentin e ndryshimit të pronësisë së mjetit;
- Në momentin e modifikimit teknik në mjet;
- Në momentin e humbjes së policës;

Për dublikatën gjenerohet një numër unik i ri (kodi_policës) dhe datë të re raportimi në Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve, por me periudhë mbulimi të njëjtë me policën e

dublikuar. Polica e dublikuar merr statusin 3 dhe polica dublikatë e vlefshme që raportohet në Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve merr statusin 4, e cila lidhet me kodin e policës dhe numrin e serisë së policës së dublikuar.

4. Statusi 5

Policat në statusin “Kthyer” raportohet për rastet kur klienti kërkon të ndërpresë gjatë periudhës së vlefshmërisë, kontratën e sigurimit të detyrueshëm duke ju kthyer edhe një pjesë e primit dhe pagesës. Procesi i kthimit të primit të policave kryhet nga përdoruesit e autorizuar, duke përditësuar statusin në 5 dhe ruhet edhe data e ndryshimit të këtij statusi.

ANEKSI 6

PORTALI I KONFIGURIMIT TË MJETEVE PA TARGË, INDIVIDËVE ME ID TË HUAJ APO INSTITUCIONEVE TË PAREGJISTRUARA NË QKB

1. Të dhënat për mjetet e qarkullimit të cilat nuk janë të regjistruara pranë DPSHTRR, të dhënat për pronarin apo përdoruesin e mjetit në rastet kur janë shtetas të huaj, të paregjistruar në regjistrin e DPGJC, si dhe NIPT-i i institucioneve shtetërore apo organizatave jofitimprurëse, që nuk janë regjistruar në QKB, do të konfigurohen manualisht nga personat e autorizuar pranë shoqërive të sigurimit nëpërmjet portalit të konfigurimit të mjeteve apo ID, në linkun:

http://ade.amf.gov.al:8280/arm_af/ade/#/login

2. Shoqëria e sigurimi duhet të zgjedhë dy deri në tre përdorues, të cilët do të pajisen nga Drejtoria e IT me username dhe password unik për aksesimin e portalit. Shoqëria e sigurimit duhet të njoftojë Autoritetin për çdo ndryshim të përdoruesve të portalit. Përdoruesi nuk duhet të jetë agjent apo punonjës shitje, por një punonjës në zyrat qendrore dhe në suport të procesit të shitjeve.
3. Pas përfitimit të të dhënave sipas pikës 1 të këtij Aneksi, shoqëritë e sigurimit, agjentët/shoqëritë e agjentëve, punonjësit e shoqërive të sigurimit, vijnë me plotësimin e të dhënave të policës dhe raportimin në Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve.
4. Përdoruesi nëpërmjet portalit konfiguron:
 - a) Mjetet ende në proces targimi që janë të zhdoganuara;
 - b) Mjete e policisë apo ushtrisë që janë të një rëndësie të veçantë;
 - c) Personat e huaj që nuk janë të regjistruar pranë DPGJC, të cilët mund të jenë pronar apo përdorues të mjetit motorik që do pajiset me policë;
 - d) NIPT e institucioneve shtetërore apo OJF që nuk janë të regjistruar pranë QKB.

Përdoruesi që konfiguron të dhënat si më sipër mban përgjegjësi të plotë për saktësinë e tyre.

5. Çdo konfigurim duhet të shoqërohet me dokumentacionin përkatës:
 - a) Për mjetet e zhdoganuara – Dokumenti i zhdoganimit, leja e qarkullimit të huaj ID e pronarit, etj;
 - b) Për mjetet e policisë apo ushtrisë – Dokumenti i tenderit ku shoqëria është shpallur fituese, dokumentet e mjeteve motorike, etj;
 - c) Për ID e huaja – Dokumenti i identifikimit të huaj;
 - d) Për NIPT e Institucioneve dhe OJF – Dokumenti i regjistrimit në gjykatë/dokumente plotësues, etj.

6. Problematikat gjatë përdorimit të sistemit, të cilat nuk adresohen në manualin e përdorimit, njoftohen me e-mail pranë Drejtorisë TI në AMF në adresën support@amf.gov.al
7. Drejtoria TI në AMF mban në gjendje pune 24/7 sistemin, menaxhimin e përdorueseve, si dhe kontrollin e të dhënave në mënyrë periodike.

ANEKSI 7

PROCEDURA E RAKORDIMIT TË SHITJEVE TË POLICAVE TË SIGURIMIT

Procedura e rakordimit të shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm të raportuara në Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve do të realizohet në mënyrë periodike çdo muaj.

Drejtoria e TI do ti dërgojë sipas formatit të miratuar, çdo fillim muaji listën e të gjitha policave të raportuara në Autoritet të shitura për muajin paraardhës duke ekstraktuar të dhënat nga data e parë e muajit, ora 00:00 deri në datën e fundit, ora 23:59, duke përfshirë të dhënat si më poshtë:

- Kodi i policës së sigurimit
- Numri serial
- Lloji
- Statusi (shitur, dublikuar, dublikatë, kthyer, anuluar)
- Data e regjistrimit
- Data e fillimit
- Data e mbarimit
- Primi
- Taksa e primit
- Totali i paguar
- Targa
- Numri i shasisë
- Data e ndryshimit të statusit
- Kodi i policës së dublikuar
- Numri i serisë së dublikuar.

Shoqëria e sigurimit pas rakordimit të këtyre të dhënave me të dhënat e sistemit të brendshëm që disponon, do të njoftojë Autoritetin për çdo problematikë të evidentuar nga ky rakordim, jo më larg se 10 ditë nga marrja e informacionit nga Autoriteti.

**Policat me statusin “Kthyer” janë polica për të cilat kthimi është realizuar gjatë po të njëjtit muaj sipas rakordimit, pavarësisht datës së raportimit të policës.*